

AISHE SULA

**RAPORTI I KOHËVE E PAKRYER, E KRYER E THJESHTË
DHE E KRYER NË MËNYRËN DËFTORE
TË GJUHËS SHQIPE”**

Ashtu si në gjuhët e tjera botërore edhe sistemi gjuhësor i shqipes ka pësuar ndryshime. Gjuhët janë përbërë nga sisteme të ndryshme. Raporti i ndryshueshmërisë së këtyre sistemeve në rrjedhën e kohës nuk është i njëjtë. Këtu përmendim si rast krahasimor ndryshueshmërinë e sistemit leksikor në raport me ndryshueshmërinë në sistemin gramatikor. Në këtë rast gjuhëtarët pranojnë njëzëri faktin se, ndryshimet e vëna re në rrafshin leksikor janë shumë më të mëdha se ato të rrafshit gramatikor, duke përdorur si njësi matëse në këtë rast elementin kohë (rrjedhë kohore). Kur flasim për sistem gramatikor, kemi të përfshirë shumë elemente të gjuhës. Që të merresh me analizimin e të gjithë elementeve të sistemit gramatikor, për të gjetur ndryshime në të, në rrjedhën e kohës, duhet punë e madhe e shtrirë gjatë në kohë.

Mbështetur në këtë arsye sfera e studimit tonë nuk është kaq e gjerë sa të përfshijë shumë apo të gjithë elementet e sistemit gramatikor, por, ngushtohet dhe rrotullohet rreth një pyetjeje. “Çfarë ka ndodhur me kohët e foljes së gjuhës shqipe në rrjedhën e kohës, konkretisht me kohën e pakryer, kohën e kryer e thjeshtë dhe kohën e kryer?”

Me anë të këtij studimi ne synojmë të bëjmë një analizim të kohëve e pakryer, e kryer e thjeshtë dhe e kryer në rrjedhë historike, duke marrë në shqyrtim shumë gramatika të gjuhës shqipe të botuara nëpër vite. Me punën tonë ne dëshirojmë të sjellim një studim më konkret dhe të prekshëm për tri kohët e foljes: e pakryer, e kryer dhe e kryer e thjeshtë të mënyrës dëftore. Për këtë arsye, edhe e kemi titulluar “Raporti i kohëve e pakryer, e kryer e thjeshtë dhe e kryer në mënyrën dëftore të gjuhës shqipe”.

Në këtë trajtesë do të ndalemi pikërisht tek aspektet kohore me të cilat një folës arrin të shprehë një veprim në të shkuarën. Do të ndalemi tek tri forma kohore të ashtuquajtura shpesh herë nga studiuesit si forma kohore “absolute” të së shkuarës (e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e

kryera), të cilat, siç, do të shprehej edhe prof. Sh. Demiraj: “Shprehin parakohësi në lidhje me çastin e ligjërit, i kundërvihen njëra-tjetrës nga pikëpamja aspektore”¹. Vlen për t’u theksuar se këto kohë i kemi studiuar duke i parë në përdorimin e tyre në mënyrën dëftore. Për ta përforcuar idenë tonë po citojmë prof. Sh. Demiraj: “Ashtu si në gjuhët e tjera i. e., edhe në gjuhën shqipe më e pasur në forma kohore është mënyra dëftore. Për më tepër, format kohore të kësaj mënyre shprehin kuptime kohore të mirëfillta, kurse në format kohore të mënyrave të tjera mbizotëron kuptimi modal”². E gjithë kjo na lejon të kuptojmë se aspektet kohore të foljes shprehen më qartazi tek mënyra dëftore në raport me mënyrat e tjera.

Sipas prof. Demiraj vetëm mënyra dëftore ka forma të posaçme për t’i shprehur të trija kohët e foljes. Po kështu, studiuesi thekson edhe vlerën që ka mënyra dëftore për larminë e formave foljore që shërbejnë për paraqitjen e kohëve të ndryshme të së shkuarës, e cila është e mangët tek mënyrat e tjera.

Jemi ndalur edhe në studimin e Anastas Dodit. Në ndryshim nga prof. Demiraj tek studiuesi Dodi kemi një studim specifik vetëm për kohën e kryer të mënyrës dëftore. Paraqesim detajet e hollësishme që studiuesi jep për ndërtimin e kohës së kryer të foljes të mënyrës dëftore sipas gjuhës letrare, siç e quan ai.

Më pas në studimin tonë kemi paraqitur edhe veçoritë e ndërtimit të kohës së kryer të dëftores sipas gjuhës popullore siç e quan A. Dodi. Në një nënçështje më vete kemi paraqitur edhe vlerën dhe përdorimin e kohës së kryer, bazuar po në studimin e A. Dodit. Kemi përfshirë në studimin tonë të dhëna të rëndësishme që na sjell studiuesi Dodi në lidhje me vlerën dhe përdorimin e kohës së kryer në rrjedhën e kohës. Sipas tij koha e kryer në gjuhën shqipe është formë e përbërë, analitike³. Ajo formohet nga e tashmja e foljes ndihmëse dhe e vetmja formë e pjesores (formë e pandryshueshme, historikisht pjesore pësore) të foljes që zgjedhohet Po kështu, kemi pasqyruar edhe kushtet në të cilat është përdorur kjo kohë dhe nuancat kuptimore që ka marrë në secilin rast përdorimor.

¹ Sh. Demiraj, “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (botim i përmbledhur). Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002, f. 311.

² *Po aty*, f. 312.

³ A. Dodi, “Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe”, Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, Me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriot -Skënderbeut, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i gjuhësisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë më, 12-18 Janar 1968, botuar 1970, f. 205.

Pas këtij citimi të gjatë që i kemi bërë studiuesit Dodi, për ta pasur sa më të plotë studimin tonë, kemi marrë në konsideratë edhe mendimin e prof. Fatmir Agalliu në lidhje me studimin e Dodit të cilit ne iu referuam më lart. Ne jemi munduar të sjellim në mënyrë të përmbledhur vlerësimet dhe rezervat që prof. Agalliu ka në lidhje me çështjen e lartpërmendur. Kështu që në nisje ai shprehet se do të ishte me interes plotësimi i materialit të A. Dodit me çështjen e përdorimit të kohëve të foljes si kohë relative dhe si kohë absolute. Në të njëjtën mënyrë ai shpreh nevojën e dallimit midis së kryerës dhe trajtave të tjera foljore me ndërtim analog, sidomos dallimi nga më se e kryera. “Këtu do të kishte interes të vihej në dukje dallimi midis së kryerës dhe trajtave të tjera foljore me ndërtim analog, sidomos dallimi nga më se e kryera. E kryera me vlerën e së kryerës së thjeshtë, si një trajtë foljore sinonimike me të, haset kryesisht nëpër fjali të pavarura kur përdoret si kohë absolute”⁴.

Prof. Agalliu, gjithashtu, shpreh rezervat e tij në lidhje me vlerat që i ka dhënë studiuesi Dodi foljes ndihmëse që në këtë rast shërben për ndërtimin e kohës së kryer. “Mendojmë se, kuptimi themelor kohor i së kryerës është ky: të tregojë një veprim të përparshëm, që kryhet para çastit kur flet personi veprues. Ky çast, ashtu siç ka treguar me të drejtë autori, shpeshherë materializohet, duke u paraqitur në formën e treguesve kohorë, ndajfolje kohe të ndryshme, ne do të shtonim këtu edhe fjalitë kohore”⁵. Si përfundim, për këtë çështje kemi paraqitur dakordësinë që prof. Agalliu shpreh me A. Dodin në lidhje me pohimin se e kryera tregon një veprim më të largët se e kryera e thjeshtë dhe e pakryera.

Pas kohës së kryer, jemi ndalur gjerësisht edhe tek koha e pakryer e foljes. Këtu, në ndryshim nga koha e kryer të cilën e sollëm paraprakisht sipas këndvështrimit të një studiuesi, kohën e pakryer e kemi sjellë të analizuar prej një grupi studiuesish. Paraprakisht për këtë çështje na duhet të theksojmë se këtu e kemi prishur paksa rendin strikt të gramatikave që

⁴ F. Agalliu, *Diskutim rreth kumtesës së A. Dodit, Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*. Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, Me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriot -Skënderbeut, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i gjuhësisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë më, 12-18 Janar 1968, botuar 1970, f. 337-38.

⁵ F. Agalliu, *Diskutim rreth kumtesës së A. Dodit, Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*. Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, Me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriot -Skënderbeut, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i gjuhësisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë më, 12-18 Janar 1968, botuar 1970, f. 337-38.

normalisht derivon nga më e reja tek më e vjetra. E kemi sjellë në këtë rend, pasi duke pasur përballë të gjitha materialet u munduam të veçonim të gjitha ato që kishin informacione në lidhje me kohën e pakryer. Duke qenë të udhëhequr nga ky fakt na u desh të citonim në këtë çështje Kristaq Cipun për shkak të materialit të vyer që kishte për kohën e pakryer. Në këtë mënyrë vetëm në këtë çështje kemi bërë një përjashtim të rregullit që vendosëm që në fillim në lidhje me renditjen e gramatikave. Vlen të përmendim këtu se ne kemi hulumtuar punimet dhe studimet e studiuesve për të gjetur atë çka mund t'i bashkonte, pra, të na sillnin të dhëna dhe pikëpamje në lidhje me kohën e pakryer të foljes. Më konkretisht fillimisht jemi ndalur tek studimi që sjell Tafil Kelmendi në lidhje me kohën e pakryer. Vlen të veçojmë përjashtjen dhe lidhjen e ngushtë që ai vëren midis kohës së tashme të foljes dhe asaj të pakryer. Këtë ide të tij e kemi ilustruar me fakte dhe argumente të shumta të sjella prej vetë studiuesit.

Në artikullin me titull “Mbi përdorimin e së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe” ai do të shprehej: “E pakryera në vështrim të ngushtë, referon jo një veprim të shkuar por shënon përkim midis një veprimi, me kohën e shqiptimit të thënies. P.sh *Agimi dje në mëngjes (po) qante në rrugë*. Është rrethandori kohor “dje në mëngjes” që shënon një pikë kohore të shkuar. E pakryera paraqitet në këtë mënyrë si homologe e së tashmes në marrëdhënie me një shenjë parakohore: në qoftë se shenjë kohore e së tashmes është çasti i shqiptimit të thënies dhe shenjë kohore e së pakryerës është çasti për të cilin folësi flet. Kështu veprimi i shënuar nga e pakryera nuk është i shkuar, - i shkuar është këndi në të cilin vendoset folësi për të kapur veprimin në të shtjelluar, në rrjedhën e zhvillimit të tij⁶.

Një tjetër studiues tek i cili jemi ndalur po për këtë çështje është gjuhëtari Enver Hysa. Prej studiuesit Hysa ne kemi veçuar punën që ai ka bërë me studimin e thellë të veprave artistike të autorëve të ndryshëm për të arritur në një përfundim në lidhje me përkufizimin dhe konceptimin e kohës së pakryer të foljes. Nga kjo punë ai kishte arritur në përfundimin se, “e pakryera është një kohë që i takon planit të së shkuarës, si e tillë ajo shpreh një veprim a gjendje që kryhet në një çast të caktuar të së shkuarës. Veçori themelore e së pakryerës është se ajo e tregon veprimin në zhvillim e sipër, gjatë kryerjes pa shënuar as fillimin as mbarimin e tij. Në këtë drejtim ajo është e afërt me të tashmen, e cila e tregon veprimin gjithashtu në zhvillim e sipër. Kështu e tashmja dhe e pakryera i kundërvihen së

⁶ T. Kelmendi, “Mbi përdorimin...”, *art. i cit.*, f. 97.

kryerës së thjeshtë dhe kohëve të tjera të së shkuarës që tregojnë veprime të mbaruara të përfunduara”⁷.

Me interes për punimin tonë pamë dhe trajtimin që prof. Hysa i bën rolit të përdorimit të pjesëzës *po* në kohën e tashme dhe të pakryer. Rëndësi i kemi dhënë dhe vlerave të ndryshme kohore që mund të marrë koha e pakryer në varësi të përdorimeve të saj

Ndalesë bëme edhe në gramatikën e At Justin Rrotës, duke sjellë informacion rreth kohëve tona. Në aspektin përmbajtësor ai do të shprehej kështu për kohët e foljes. “Verbi është e vetmja pjesë e ligjëratës që njëherit me veprën, tue veshë trajta të ndryshme, difton edhe kohën në të cilën kryhet puna, d.m.th. a ka ndodhë ky veprim, a është tue ndodhë, ase a ka për të ndodhë. Kështu ai njih tri kohë themelore: e tashmja, e kaluemja, e ardhëshmja. Diftorja i ka të gjitha kohët. Si kohë të kryera të diftores ai njih kohën e pakryeme: *shkojshe*, aoristin: *shkova*, e përtejkaluemja: *paçë shkue*, e kaluemja ase e kryemja I: *kam shkue*, e kaluemja II: *kam pas' shkue*, e tejkaluemja: *kisha shkue*, e ardhëshmja: *kam me (për të) shkue*, *do të shkoj*, e paraardhëshmja: *do të kém shkue*”⁸.

Kohët tona që kemi në studim, tek At Justini, sëbashku me përkufizimin e tyre saktësisht i gjejmë kështu: “E pakryemja difton një punë të ndodhunë dikur, përparandej; e cila zhvillohej njëkohësisht, ndërsa kryhej një punë tjetër. Përdoret sidomos ndër përshkrime: *Unë vjshë e shkojshe aty, si t'ishë në shtëpi teme. Ai gjithnje flitë; por s'i a vente veshin kush*”⁹. Koha e pakryer që përkufizohet në gramatikën e akademisë së sotme shqipe është e njëjtë me emërtimin që At Justin Rrota shkruan në gramatikën e tij, theksojmë se ai lëvtron gegërishten.

Kohën e kryer të thjeshtë tek ai e gjejmë të emërtuar si aorist. Saktësisht ai shprehet: “Aoristi shenjon një fakt a një veprë të kryeme aty për aty ndërsa flasim; këndeje e quejn edhe prezent i së kryemes: *Unë i shkova në shtëpi, por nuk e gjeçë në shtëpi. Mbaroi, e pat edhe kjo*”¹⁰.

Mirëpo, po ashtu për aoristin shkruan edhe një vërejtje: “Shqip aoristi, përkrahë koha, jep një punë të ndodhunë fort më afër se vepra, që tregon e kaluemja e thjeshtë. Khs. *Unë qeshë, por s'e gjeçë në shtëpi* (punë

⁷ E. Hysa, *Rreth përdorimeve të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, në “Studime filologjike”, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 102.

⁸ At Justin Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botimi I, “Botime Françeskane”, Shkodër, 2006, f. 345.

⁹ *Po aty*, f. 346.

¹⁰ *Po aty*, f. 346.

e tashme). Ndërsa, *unë kam qenë, por nuk e kam gjetë në shtëpi*. (punë e herëshme)¹¹.

Kohën e kryer e shohim të emërtuar si e kaluemja e thjeshtë dhe e përkufizon: “E kaluemja e thjeshtë tregon një punë ndodhunë kahë ditë, edhe ma përpara se vepra e aoristit: *A kë qenë ndonjë herë i ri? Kur kanë ardhë ata, mue s’më kanë gjetë aty*”¹².

Aty pamë që mënyrës dëftore ai i njeh nëntë kohë teksa jep edhe përkufizimin për to, mirëpo teksa shohim pasqyrën e e zgjedhimeve të foljeve, kuptojmë mungesën e kohës së kryer në zgjedhimin e verbave të fortë (mënyra dëftore na jepet me tetë kohë), pasi në zgjedhimin e verbave të ligshhtë nuk mungon.

Në gramatikën e Cipo jemi munduar të mbledhim idetë e tij në lidhje me tri kohët që ne kemi në studim. Gjuhëtari fillimisht jep përkufizimin e tij për secilën kohë, më pas ne i kemi dhënë rëndësi edhe vlerave përdorimore që ai i atribuon secilës kohë. Ky gjuhëtar ndalet gjerësisht tek koha e kryer e thjeshtë që për të njihet me termin “aorist” dhe fare pak tek koha e kryer për të cilën jep thjesht një përkufizim. Më poshtë po shpërfaqim konceptet e gjuhëtarit Cipo në lidhje me tri kohët që ne kemi marrë në shqyrtim. E nisim nga koha e pakryer e foljes që tek Cipoja gjendet me termin imperfekt¹³.

Sipas Cipo kjo kohë tregon një punë në kohën e kaluar pa zënë në gojë fillimin dhe mbarimin e saj. Kjo punë mund të mbajë gjatë ose mund të përsëritet; p.sh. *Hante e pinte mbi kuriz të botës (përsëritje)*. Mund të tregojë edhe idenë e bashkëkohësisë; p.sh. *Sa herë që hapte gojën zhurma rifillonte*. Për këto cilësi që ka përdoret për ti dhënë shpirt një fjalimi a një përkufizim të ligjëratës këmbësore a të ligjëratës së matur; p.sh. *Paniku mbretëronte në tërë Shqipërinë*. Trajtat e prezentit dhe të imperfektit mund të shoqërohen ose jo me pjesëzën “po”. Kur janë të pashoqëruara tregojnë një veprim abstrakt, të përgjithshëm ose të përsëritur; P.sh. *Flas tyrgisht, frengjisht, flas ç’më vjen nëpër gojë*. Po kur duam që të kemi veprim konkret dhe të caktuar, përdorim pjesëzën “po”; P.sh. *Me sy të vrarë e të përletur po putheshin njëri me tjetrin sikur nuk do të shiheshin më*.

Vijojmë të qëndrojmë tek gjuhëtari Cipo dhe tani ndalemi tek koha e kryer e thjeshtë që për Cipo do të njihet si aoristi.

¹¹ *Po aty*, f. 346.

¹² *Po aty*, f. 346.

¹³ K. Cipo, *Gramatika Shqipe*, Instituti i Shkencave, Ndërmarrja shtetërore e botimeve dhe shpërndarjes, Tiranë, 1949, f. 112-114.

1) Nënvizon një punë të bërë në një kohë të largët ose të afërt, por gjithmonë të kaluar, andaj e përjashton idenë e vazhdimësisë dhe të aktualitetit; p.sh. *Kryengritja popullore u sigurua me një radhë fitoresh të shkëlqyera kundër barbarit nazist.*

2) Aoristi është dhe koha e fjalive gnomike, se me të janë shprehur qëndrime të arta në trajtë proverbash; P.sh. *Ngardhi dhia, u prish miqësia. Siç këndoi gjeli plak, do të këndojë dhe gjeli i ri.*

3) Tregon veçanërisht, edhe fillimin e një pune a të një mënyre të qeni me anë të atyre foljeve që kanë idenë e aspektivitetit; p.sh. *Me të vajtur Skënderbeu në Lesh ra i sëmure. Vajta në bjeshtë për tu çlodhur dhe më zunë ethet.*

4) Aoristi mund të tregojë edhe një punë që është kryer dhe ka marrë fund, por që efekti i saj shtrihet edhe në prezent. Është me fjalë të tjera si një aorist i tanishëm; P.sh. *Dëgjove? = Di gjë? Erdhi dita e flamurit = Ja ku është. E zbërtheva problemin = Ja rezultati. E gjeç = Ja ku është.*

5) Kur duam ndonjëherë që t'i veshim seriozisht idenë e vazhdimit të punës atëherë përsërisim foljen; P.sh. *Qau e qau shtëpinë e qulli.*

6) Mund të përdoret aoristi edhe në vend të të pritmit (të së ardhmes), kur dimë me siguri se ajo punë do të ndodhë patjetër; P.sh. *Në të zënça, ta kripa kokën.*

7) Mund të marrë edhe kuptimin e prezentit kur vë në dukje një të vërtetë të zakonshme; P.sh. *Mor po si s'e tha ky njeri një fjalë të vërtetë.*

Ndalemi tashmë tek koha e kryer të cilën gjuhëtari Cipo e fut te grupi i kohëve të përngjitura dhe e përmend me termin perfekti.

Perfekti (i kryeri) tregon një punë që ka marrë fund prej kohësh, veç se lidhjet me kohën e tanishme akoma s'i ka prerë, kjo do të thotë se pasojat e saj arrijnë gjer në kohën tonë; p.sh. *Ky djalë që po vjen, s'ka hequr kurrë sëmundje. Vetëm sot e kam kryer detyrën si duhet. Kam kohë që më s'kam parë një thëllëzë kaq të bukur¹⁴.*

Një tjetër gjuhëtar gramatikën e të cilit kemi marrë në shqyrtim është Osman Myderrizi. Për vetë pikëpamjet interesante që kemi gjetur në gramatikën e këtij gjuhëtari jemi ndalur dhe kemi veçuar idetë e tij të përgjithshme në lidhje me kohët e foljes. Ai do ta niste në këtë formë të shprehurit për kohët: "Mënyrat, punën a të qenmen mund ta tregojnë në

¹⁴ K. Cipo, *Gramatika Shqipe*, Instituti i Shkencave, Ndërmarrja shtetërore e botimeve dhe shpërndarjes, Tiranë, 1949, f. 115.

kohë të ndryshme: *shkoj - shkojshem - shkova - do të shkoj*. Kohët e para janë: e tashmja, e shkuemja, e ardhëmja”.

E shkuemja shërben për të tregue çastin e të ngjimit të punës mâ me përpikmëni dhe ka tetë forma: të pakryemen, të kryemen e thjeshtë, të kryemen, të kryemen e plotë, të kryemen e tejshkueme, mâ se të kryemen, mâ se të kryemen e plotë, mâ se të kryemen e tejshkueme”¹⁵. Sipas Myderizit, kohët, kur tregohen vetëm me një fjalë quhen të thjeshta: **shkoj, shkojshem, shkova**; kur tregohen me dy a më shumë fjalë quhen të përbëra (përbame): **kam shkue, kam pasë shkue** etj;

Ne do të ndalemi tek tri kohët që na interesojnë më së shumti. Tek dy kohët e thjeshta, dhe këtu po shprehemi po sipas studiuesit Myderrizi, “e pakryemja, e cila difton një punë a të qenme që vazhdonte në kohën e shkueme pa tregue fillimin e mbarimin e saj: **shkonte, rrinte**.

E kryemja e thjeshtë, e cila difton një punë a të qenme krejt të kryeme në kohën e shkueme: **shkova, ndejta**. Kjo kohë ndonjiherë përdoret edhe si kohë e tashme: *Prit se erdha (prit se po vij)*. E ndonjiherë edhe si kohë e ardhshme: *Rrini urtë se ju lashë pa darkë (rrini urtë se do t’ju lâ pa darkë)*”.

Ndalemi tashmë tek koha e kryer që për studiuesin do të quhej e kryemja dhe do të bënte pjesë në grupin e foljeve “të përbâmë”.

“E kryemja e cila difton një punë a të qenme të kryeme në një kohë të shkueme t’afërme: **kam shkue**”.

Tek Xhuvani vëmë re që kohët që ne jemi duke studiuar i përfshin në një grup të quajtur “kohë absolute”. Numrin i kohëve të mënyrës dëftore që paraqet Xhuvani e gjejmë edhe në Gramatikën e Akademisë së Shkencave, pra, i atribuohen tetë kohë. Për secilën kohë foljeje nuk gjejmë ndonjë përkufizim, por, format foljore të secilës kohë i shohim të materializuara në zgjedhim.

Xhuvani i njuh foljes tri kohë kryesore. Më konkretisht kohën e tashme, kohën e shkuar dhe kohën e ardhme. Për kohët e foljes ai do të shprehëj: “Folja ashtë në kohën e tashme kur dëften një punë që bahet n’atë kohë që flasim. P.sh. *Nxënësi shkruen mësimin*. Folja ashtë në kohën e shkueme, kur kallëzon një punë që u ba në një kohë të shkueme. P.sh. *Nxënësi shkroi mësimin*. Folja ashtë e kohës së ardhëshme, kur tregon një

¹⁵ O. Myderrizi, *Gramatika e re e shqipes*, Për shkollat e mesme, Vëllimi I, Fonologji e morfologji, Tiranë, 1944, f. 121-122.

punë që do të bëhet në një kohë që ka me ardhë. P.sh. *Nxënësi ka me shkrua a do të shkrujë mësimin*”.

Të para në këtë mënyrë Xhuvani do të bënte një të tillë pasqyrë për kohët e foljeve në përgjithësi. Ai do të shprehej për kohën e tashme se ka vetëm një formë: *këndoj, shkruaj, flas* etj. Koha e shkuar ka pesë forma që sipas studiuesit do të quheshin:

E pakryeme, p.sh. *punojshem, punoja*

E kryeme e thjeshtë, p.sh. *punova*

E kryeme, p.sh. *kam punue*

E kryeme e plotë, p.sh. *kishjem punue*

E kryeme e tejshkueme, p.sh. *pata punue*

Koha e ardhme gjendet në dy forma:

E ardhme e tashme, p.sh. *kam me punue, do të punoj*

E ardhme e përparme, p.sh. *kam me pasë punue, do të kem punue*

Një konceptim krejtësisht të pahasur më parë për kohët e foljeve e kemi parë tek studiuesi Ilia Dilo Sheperi. Tek Sheperi gjejmë të përdorur për kohën e pakryer dhe për kohën e kryer dy terma të tjerë, e pakryer e përngjitur dhe e pakryer e dypërngjitur, po kështu, kemi edhe termat e kryer e përngjitur, e kryer e dypërngjitur. Në fakt këto katër terma të rinj përfaqësojnë kohë më vete, të cilat tek gjuhëtarë të tjerë i gjejmë me terma të tjerë si emërtime të kohëve të foljeve. Këtu kohën e kryer e thjeshtë e kemi p.sh. *çela*, ndërsa kohën e kryer e gjejmë nën termin e tashme e dypërngjitur p.sh. *kam çelur*.

Në kreun e dytë të punimit të përbërë nga shtatë nënçështje ku përqendrohemi në gramatikën e studiuesve të kohës, dëshmi këto, të rralla të gjuhës shqipe. Së pari, marrim në shqyrtim studiuesin Iljas Jahja Përmeti. Tek ai veçojmë konceptimin e tij në lidhje me foljen në përgjithësi. Studiuesi e quan foljen me termin **ftillk** dhe bën këtë përkufizim për të: “Ftillk thirret ajo pjesë e ligjëratës e cila kallëzon një qenësie ose një veprim që ngjan me një kohë; P.sh. *unë këndoj, ti shkruan, ai fle, ajo punon; na kemi, ju jini, ata qenë*; etj etj. Ftillk i vërtetë është ftillku *me qenë*; t’jerët quhen ftillke kallëzimore¹⁶.”

Ftillket ndahen më tri dukshesh e, janë: ftillke *veprorë*, ftillke *pësimorë* e ftillke *asjatërorë*. Ftillku *vepruar* është ai që kallëzon një veprim

¹⁶ I. Jahja Përmeti, *Fillime të Gramatikës Shqipe*, për Shkollat Përmetare, Pjesa e parë, Boston, Mass. 1917, f. 98-99-102.

ose një punë që bëhet prej subjektit. Tregime: Unë *lëçit* mësimet; ti *shkruan* letrën; ai *punon* nd'aret;

Ftillku *pësimor* është, ai që dëfton një pësim ose një ngjarje q'e-pëson subjekti. Tregime: unë *lodhem* së punuari; ti *vuan* nga koka; ai *lëngon* prej sëmundjes; djali *u-rrah* prej mësonjësit; vajza *u qortua* prej mëmës; etj.

Ftillku *asjatërore* janë ata që rrëfejnë një punë që mbetet po tek ai që flet; tregime: *fryn* erë; *bie* shi; *qimton* bore; *veson*, *gjëmon*, *vetëtin*; etj. Me çdo ftillk vërejmë disa ndryshime, të cilat janë: *numëri*, *vehtja*, *koha e mënyra*. Ftillku ka dy *numera*: *veçorin* edhe *shumorin*. Ka tri *vehte*: *veht'e-parë* (*unë*, *na*); *veht'e-dytë* (*ti*, *ju*) e *veht'e-tretë* (*ai*, *ajo*, *ata*, *ato*); ka dhe tri *koh*, e janë: *koha e tanishme*, *koha e shkuar* e *koha e ardhëshme*; ka edhe dy *mënyra*, e *thirren*; *mënyr'e-skanjuarë* e *mënyr'e-paskanjuarë*. Ftillku është i *mënyrës së skanjuarë*, kur ka *numërin*, *vehtet* edhe *kohët* të dalluara mirë; tregime: *unë kam*, *ti je*, *ai shkon*, *na punojmë*, *ju shkruani*, *ata këndojnë*.

Mënyra e sh-kanjuarë ndahet edhe këjo me gjashtë dukesh t'-jera që janë: *mënyra deftoare*, *mënyra urdhërore*, *mënyra lidhore*, *mënyra dëshirore*, *mënyra qyshkore* e *mënyra mospandehore*.”

Tani po paraqesim një pasqyrë të kohëve të foljeve të mënyrës dëftore sipas studiuesit Iljas Përmeti.

Ndërsa për kohët e veçanta për të cilat ne interesohemi nuk jep ndonjë sqarim a përkufizim të veçantë. Për ta plotësuar këtë “mangësi”, në punimin tonë kemi përfshirë një pasqyrë të zgjedhimit të foljes *kam* në të gjitha kohët e mënyrës dëftore prej të cilave më pas kemi veçuar të veçantat e tri kohëve tona.

Studiuesja Sevasti Qiriazzi Dako, na paraqet specifika të ngjashme me studiuesin paraardhës. Veçori të shumta për mënyrën dhe kohët e foljes në përgjithësi, por, shumë pak informacione për kohët absolute në veçanti. Vlen të përmendet se kjo studiuese i njeh foljes gjashtëmbëdhjetë kohë. Kohët e pakryer, e kryer e thjeshtë, e kryer janë të pranishme në pasqyrën e foljeve të paraqitur prej saj por, me emërtime të tjera. Përkatësisht:

e pakryer = i-parthim

e kryer e thjeshtë = i-shkuarë Mote. Ndërsa për foljen në përgjithësi ajo do të shprehej kështu.

Ndyrshimet që merr një folje për të treguar kohë quhet mot. Motet më të shënuara të një foljeje janë tri: koha e tanishme; koha e shkuarë, edhe koha e pritme¹⁷.

Koha e tanishme. Forma e një foljeje, që tregon se veprimi bëhet në kohën e të folurit quhet koha e tanishme. Kështu; *Unë këndonj një libër të intersaçme.*

Koha e shkuarë. Forma e një foljeje, që tregon se veprimi i foljesë është i mbaruarë përpara kohës foljes, quhet koha e shkuarë. Kështu, *Unë këndova një libër të intersaçme.*

Koha e pritme. Forma e një foljeje që tregon se veprimi i foljes do të ngjasë në kohë të pritme, quhet koha e pritme. Kështu, *Unë do të këndoju një libër të intersaçme.*

Emërat e motevet. Një folje ka gjashtëmbëdhjetë forma të ndryshme për të treguar kohën kur bëhet veprimi i foljes. Emërat të këtyre 16 forma të ndryshme janë këto: *i-tanishmë, i-parthim, i-shkuarë, i-papandehurë i-tanishmë, i-papandehurë i-parthim, i-paratanishmë, i-mëparthim, i-parëshkuarë, i-papandehurë i-paratanishmë, i-papandehurë i-mëparthim, i-pritmi i-tanishmë, i-pritmi i-parthim, i-pritmi i-papandehurë, i-pritmi i-paratanishmë, i-pritmi i-mëparthim, i-pritmi i-parëpapandehurë.* Nga këto gjashtëmbëdhjetë forma të ndryshme, tetë janë të thjeshta, dhe të tjerat tetë janë të përzjera.

Shënim. Vetëm mëndyra e preme i ka të gjitha këto gjashtëmbëdhjetë forma, mëndyra e varme ka vetëm gjashtë, të tjerat mëndyra vetëm nga dy.

e kryer = i-parëtanishmi.

Format kohore foljore paraqiten të afërta me format e standardit të sotëm, por, edhe këto nën ndikimin e dialektit toskë.

Gaspër Mikeli është një tjetër studiues në gramatikën e të cilit jemi ndalur. Gramatika e tij që e vyer për punimin tonë se patëm mundësinë të shihnim tek ai një trajtesë të kohëve që na interesojnë, por, në dialektin gegë.

ai do të shprehej në këtë mënyrë për kohët e foljes në përgjithësi: “Verbi mund t’na diftojnë se veprimi a puna po ndoll njëtesh, se ndolli parë, se kaa ndollë mas tashit d.m.th. mâa vonë. Verbi praa mundet me na diftue t’punuemit a t’gjetmen n’katër kohë: n’kohë t’tashme, n’kohë

¹⁷ S. Q. Dako, *Gramatikë Elementare për Shkollat Filltare*. Botimi i 2-të, Printed by The Davis Press, Worcester Mass., U. S. A. 1916, f. 57-58 ; 60-61-62.

t'parshme, n'kohë t'kalueme e koha e ardhshme". Sipas studiuesit Mikelit këto kohë" thirren katër kohët e rendit të parë"¹⁸.

Ai i njuh foljes dymbëdhjetë kohë por, siç theksuam më lart ai nuk jep sqarime teorike rreth kuptimit dhe përdorimit të secilës kohë. Mikeli jem material të shkurtër rreth njohjes së tri nocioneve kohore, e tashme, e shkuar, e ardhme. Në një rend emërtimi kohët e tij do të paraqiteshin në këtë formë:

1. Koha e tashme - *unë shkoj, ose po shkoj*
2. Koha e porsitashme - *unë shkoshë, ose po shkoshë*
3. Koha e pashme - *unë shkova*
4. Koha e atëhershme - *unë kam shkue*
5. Koha e porsitashme e kalueme - *unë kishe shkue*
6. Koha e parshme e kaluese - *unë paçë shkue*
7. Koha e atëhershme e kaluese - *unë kam pasë shkue*
8. Koha e porsitashme e përtejkalueme - *unë kishe pasë shkue*
9. Koha e parshme e përtejkalueme - *unë paçë pasë shkue*
10. Koha e atëhershme e përtejkalueme - *unë kam pasë pasë shkue*
11. Koha e ardhshme - *unë kam me shkue, do t'shkoj*
12. Koha e paraardhshme - *unë do t'keem shkue*

Tek studiuesi Xanoni nuk kemi gjetur material të mirëfilltë teorik për çështjen që kemi në studim. Ajo çka paraqesim prej tij është një pasqyrë zgjedhimi kohësh të ndryshme foljesh. Prej kësaj pasqyre nxorëm një analizë të hollësishme të kohëve të foljeve që jemi duke studiuar dhe të kohëve të tjera në përgjithësi. Një aspekt shumë interesant që vumë re, është emërtimi që i bën studiuesi kohëve të mënyrës dëftore. Kështu koha e quajtur prej ti *qetashe* i përgjigjet kohës së *tashme* në standard, *e pakryeme* = *e pakryer*, *e ngiatkalueme* = *e kryer*, *e largkalueme* = *e kryer e thjeshtë*, *e ngialtejkalueme* = *më se e kryer*, *e fieshtëpërtardhme* = *koha e ardhme* por me ndërtimin "kam me + pjesore" dhe jo me "do të", *e parandiejpërtardhme* = *e ardhme e përparme*'.

Më poshtë po sjellim një pasqyrë të kohëve të mënyrës dëftore ashtu siç i ka dhënë Xanoni në veprën e tij

Mënyra dëftore ka tetë kohë: *Qetashen, e Pakryemen, Ngiatkaluemen, Largkaluemen, Ngiatejkaluemen, Largtejkaluemen, Fieshtëpërtardhmen, Parandiejpërtardhmen*.

¹⁸ G. Mikeli, *Gramatika e gjuhës shqype*, Shtypshkronja "Nikaj", Shkodër, 1916, f. 64.

E Pakryeme

<i>Nj.</i>	Un ishe o ishem Ti ishe Ai ishte	<i>Nj.</i>	Un kishe o kishem Ti kishe Ai kishte
<i>Sh.</i>	Na ishim Ju ishi Ata ishin	<i>Sh.</i>	Na kishim Ju kishi Ata kishin

E ngiatkalueme

<i>Nj.</i>	Un kam kënë Ti kee kënë Ai kaa kënë	<i>Nj.</i>	Unë kam pasë Ti kee pasë Ai kaa pasë
<i>Sh.</i>	Na kena o kemi kënë Ju keni o kini kënë Ata kan kan kënë	<i>Sh.</i>	Na kena o... pasë Ju keni o kini pasë Ata kan pasë

E largkalueme

<i>Nj.</i>	Un kieshë o kieçë Ti kие Ai kie	<i>Nj.</i>	Un paçë o pata Ti pate Ai pat
<i>Sh.</i>	Na kiemë o... Ju kietë Ata kienë o...	<i>Sh.</i>	Na patëmë o patmë Ju pattë Ata patën o patnë

Kemi marrë gjithashtu në konsideratë edhe këndvështrimin e Sami Frashërit për kohët e foljes ose motet siç i quan ai. Siç na u bë traditë tashmë, fillimisht jemi ndalur tek këndvështrimi i tij i përgjithshëm për kohët dhe më pas tek prekja konkrete e tri kohëve tona. “Folja ka gjashtëmbëdhjetë mote: i-tashmi si: *vete, vinj*; i-parthim si: *vinja, thosha*; i-shkuarë si: *vajta, ardhçë*; i-papandehur i-tanishëm si: *vajtëkam, ardhëka*; i-papandehur i-parthim si: *vajtkështa, ardhkëshinë*; i-parëtanishim si: *kam vajturë, kini thënë*; i-mëparthim si: *kisha vajturë, kishitë thënë*. i-parëshkuarë si: *paçë vajturë, pat thënë*; i-papandehur, i-parëtanishim si: *paskam vajturë, paske thënë*; i-papandehur i-mëparthim si: *paskëshimë vajturë, paskej thënë*; i-pritm’i-tanishim si: *do të vete, do të vinj*; i-pritm’i-parthim si: *do të vinja, do të thosha*; i-pritm i-papandehurë si: *do të*

vajtkështa, do të thënkështa; i-pritm' i-parëtanishim si: *do të kem vajturë, do të kem thënë*; i-pritm' i-mëparthim si: *do të kisha qenë*; i-pritm' i-parëpapandehurë si: *do të paskështa ruajturë, do të paskështa qenë*. Nga këto gjashtëmbëdhjetë kohë, tetë janë thjeshta, tetë janë të përziëra, sikundër duket edhe në shembëllat e tyre¹⁹. Nga mënyrat që numëruam më sipër, ca i kanë të tëra këto mote, disa kanë vetëm një pjesë.

Pas kësaj pasqyre të përgjithshme të kohëve të foljes të mënyrës dëftore, sipas Sami Frashërit, është momenti të ndalemi më konkretisht tek kohët e foljes që ne po shqyrtojmë. Kështu po ndalemi tek emërtimet e veçanta që Frashëri iu vendos secilës prej kohëve dhe tek një pasqyrë e shkurtër për çdo kohë. Si rezultat kemi këto kohë respektivisht.

E paktyer = I-parthim

kisha, kishnja kishimë

kishe, kishnje kishitë

kish (te) kishinë

E kryer e thjeshtë = I-shkuarë

pata, paçë patmë

pate pattë

pat, pati patnë

E kryer = I-parëtanishim

kam pasurë kemi pasurë

ke pasurë keni pasurë

ka pasurë kanë pasurë

Ndalesë kjo që do të pasohet me një analizë tonën në lidhje me atë që përcjell Sami Frashëri për këto tri kohë që për ne paraqesin interes.

Së fundmi, shënojmë me rëndësi të madhe punën e gjuhëtarit Kostandin Kristoforidhi. Merita e Kristoforidhit për studimin tonë është pasqyra e kohëve të foljeve të pjesës më të madhe të të folmeve të dialektit toskë. Kristoforidhi si risi sjell një numër të madh të shtuar të kohëve të foljes. Në këtë mori kohësh ndeshim mungesën e kohës themelore, koha e kryer e thjeshtë, mungesë të cilën nuk e vërejmë tek studiuesit më vonë.

¹⁹ S. Frashëri, *Shkronjëto e Gjuhësë Shqip*, Prej. S. H. F., Shtypurë prej shoqërisë "Dritë" që ka qëndrimnë në Bukuresht të Rumanisë, 1886. f. 127-128, 131-132.

Në fund të punimit tonë për të parë arritjet dhe vërtetimin ose hedhjen poshtë të tezave që ngritëm dhe për t'iu përgjigjur që ngritëm në fillim të punës po përpiqemi të nxjerrim disa përfundime që ne na u dukën më bazike.

Kohët e foljes së mënyrës dëftore kanë ekzistuar në shfaqjet e para të gramatikave të gjuhës shqipe. Emërtimet e tyre ishin të ndryshme nga ato që njohim ne sot ndërsa format foljore të njëjta.

Format foljore me anë të të cilave shprehen kohët; e pakryer, e kryer e thjeshtë dhe e kryer duke i marrë në analizë në rrjedhën e kohës vërejmë se nuk kanë ndryshuar.

Në gramatikën e Kristoforidhit shohim mungesën e kohës së kryer të thjeshtë. Në gramatikat e mëvonshme do ta shohim atë të pranishme.

Duke pasur parasysh analizimin që i kemi bërë pasqyrave foljore të gramatikave që i përkasin studiuesve të periudhave të ndryshme kohore, kemi vënë re se format foljore të këtyre kohëve, kanë ardhur duke u kristalizuar pra, duke u skalitur shumë pak në rrjedhën e kohës, për të arritur deri në format e standardit të sotëm.

Nga shqyrtimi i gramatikave kemi vërtetuar se nuanca kuptimore që shpreh secila nga kohët e marra në analizë ka qenë historikisht e njëjtë.

Në përfundim të studimit tonë vërtetua se këto tri kohë kanë ekzistuar në të gjithë rrjedhën e historisë, përveç rastit të Kristoforidhit, të cilin e përmendëm më lart.

Format foljore me të cilat paraqiten këto tri kohë, në rrjedhën e kohës, nuk kanë ardhur duke u zgjeruar, përkundrazi ashtu siç u shprehëm më lart, janë skalitur nga pak.

Kur u ndalëm tek nuancat përdorimore të secilës kohë, të para në gjuhëtarë të ndryshëm shohim që, ka raste kur afrohen konstatimet e gjuhëtarëve, ka raste të tjera shtimi ose pakësimi vlerash të tilla.

Çështja e emërimit të kohëve e pakryer, e kryer e thjeshtë dhe e kryer, ishte ajo që u vu re menjëherë dhe që i diferenconte më së shumti studiuesit. Themi i diferenconte sepse pothuajse tek çdo studiues këto kohë i kemi gjetur me emërime të ndryshme.

Duke i parë këto kohë në aspektin krahasimor kemi vënë re se kur bëhet fjalë për çështjen ndërtimore, është një kohë e cila ka një element krejtësisht të ngjashëm me një kohë tjetër. Në këtë rast bëhet fjalë për ndërtimin me pjesëzën *po* që gjendet në të njëjtin konstrukt si tek koha e pakryer ashtu edhe tek koha e tashme e foljes. Madje nuanca kuptimore që shpreh prania e saj është e njëjtë në të dyja rastet (një veprim që është duke ndodhur). Diferenca është se veprimi në njërin rast është duke ndodhur në

të tashmen po punoj, në rastin tjetër është duke ndodhur në të shkuarën po punoja.

Po të vërejmë me kujdes përkufizimet që japin gjuhëtarët, të cilët i përkasin periudhave të ndryshme historike, në lidhje me tri kohët tona, do të arrijmë në përfundimin se përkufizimet janë shumë të afërta ose të njëjta. Këto përkufizime nuk i gjejmë asnjëherë me ndryshime rrënjësore.

Edhe në kohën kur në një gramatikë të gjuhës shqipe, mënyrës dëftore i atribuoheshin gjashtëmbëdhjetë kohë për kohët që ne po shqyrtojmë do të kishim këto emërtime për të njëjtat forma foljore që ka edhe standardi i sotëm; a) i-parthim = e pakryer; b) i-shkuarë = e kryer e thjeshtë; c) i-parëtanishmi = e kryer.

Konceptet: e shkuar, e tashme dhe e ardhme gjenden në të gjithë gramatikat që kemi në studim.

Sheperi, i njuh mënyrës dëftore 24 trajta kohore, kohët absolute janë të pranishme, emërtohen ndryshe por format janë të njëjta.

Raporti i përafërsisë së kohës së tashme me kohën e pakryer është përmendur pothuajse tek të gjitha gramatikat e gjuhëtarëve të marrë në shqyrtim.

Shkak i vënies së emërtimeve të ndryshme të kohëve, prej gjuhëtarëve është edhe origjina e tyre që nënkupton prejardhje të ndryshme dialektore ose të të folmeve.

Studiuesit pranojnë njëzëri se mënyra dëftore është ajo mënyrë që i përmban të gjitha kohët që përdoren në gjuhën shqipe.

Në një Gramatikë të vitit 1917, e gjitha në dialektin gegë, struktura e formave foljore të kohëve që ne studiuam nuk kishte ndryshime të mëdha nga ajo e standardit të sotëm ose e punimeve të gjuhëtarëve të tjerë. Ndryshimet formale konsistonin vetëm në rrafshin fonetik.

BIBLIOGRAFI

GRAMATIKA

- Cipo, K., *Gramatika shqipe*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1949.
- Dako S. Q., *Gramatikë elementare për shkollat filltare*, Botimi II-të, Printed by: The Davis Press, Worcester Mass., U. S. A. 1916.
- Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
- Demiraj, Sh., *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*. II, Universiteti Shtetëror i Tiranë, Fakulteti Histori-Filologji, Katedra e gjuhës shqipe, Tiranë, 1961.

- Dodbiba, L., - Spasse, S., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Pjesa e parë. Fillimet e sintaksës, Fonetika-morfologjia, Për klasën V dhe VI të shkollës shtatëvjeçare, Tiranë, 1951 (ribotime në vitet 1953, 1955, 1957).
- Frashëri, S., *Shkronjëtores e gjuhës shqip*, Vepra 5, përgatiti për shtyp Rexhep Ismajli. Prishtinë, 1979.
- Gramatika e gjuhës shqipe*. 1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 2002.
- Kristoforidhi, K., *Gramatikë e shqipe sipas dialektit toskë*. Vepra 1. Universiteti "Aleksandër Xhuvani" (përkthyer nga greqishtja nga Aristotel Spiro) 2001.
- Mikeli, G., *Gramatika e gjuhës shqipe*, "Nikaj", Shkodër, 1916.
- Myderrizi, O., *Gramatika e re e shqipes, për shkollat e mesme, vëllimi I, Fonologji e morfologji*, 1944. "Gutenberg", Tiranë, 1944.
- Përmeti I J., *Fillime të gramatikës shqipe për shkollat përmetare*, Pjes e parë, Boston Mass. "Diell", 1917.
- Rrota, J., *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botimi I, "Botime Françeskane", Shkodër, 2006,
- Sheperi, I. D., *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomos i toskënishtes* (për shkollat e mesme), "Vlora" G. Direttore & C., Vlorë, 1927.
- Xanoni, S. J., Anton M., *Gramatika shqyp*, "Zoja Papërlyeme", Shkodër, 1909.
- Xhuvani, A., *Libri i gjuhës shqipe*, Pjesa e dytë për klasët e nalta të Filllores e të parat e Qytetses. Shtëpia botonjëse "Kristo Luarasi", Tiranë, 1942.

MONOGRAFI

- Çerpja A., *Norma letrare në sistemin foljor. Vështrim historik-analitik i traditës gramatikore të shqipes*. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Albanologjike, Shtypshkronja "Classic Print", Tiranë, 2015.
- Kelmendi, T., *Funksionet e kohës foljore të pakryer në shqipen e sotme letrare*. - Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë 1993.
- Topalli., K., *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, "Plejad", Tiranë, 2010.

ARTIKUJ

Agalliu, F., *Diskutim rreth kumtesës së A. Dodit "Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe"*, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike III, 337-338.

Dodi, A., *Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*. – Studime filologjike 22(5)/1968, 1, 59-74. [Përmb. frëngjisht] Tiranë, 1968.

Dhrimo, A., *Rreth trajtës normative të së kryerës së tejshkuar*. – GJ, 6/1968, 2, 73-77.

Kelmendi, T., *Mbi përdorimin e së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe*. – GJ, 27/2007, 1-4, 96-105.